BANKA KOMBËTARE E SHQIPNÍS
BANCA NAZIONALE D'ALBANIA

FJALIM

I MBAJTUN PREJ KRYETARIT SHKELQESIS SË TIJ SEN. A. MOSCONI PËR INAUGURIMIN E SELIS SË RE' NË TIRANË

30 TETUER 1938

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

Naltësi Mbretnore, Shkëlqesa, Zoja, Zotnìj,

Tue marrë fjalën për herën e parë në tokën e Shqipnìs, kaq e dashtun në zêmrën t'ême si italian e për kujtimet shekullore historike që pasqyrohen n'emnin e Heroit Kombëtar Skanderbeg ashtu edhe për miqsìn' e shtrêjtë që bashkon prej kohësh vllaznisht të dy popujt, mendimi i êm i parë kthehet me riverencë ndaj Nalt Madhnís së Tij Mbretit Zog I, që aq meritueshëm personifikon Kombin Fisnik e të vlefshëm Shqiptar.

Nalt Madhënia e Tij Pat mirësin të na bëj nderin e nalt, që qy inagurim, të mbahet në pranin e në për krahjen të njanës nga Motrat Auguste të Tij, e çila na, bije në mes t'onë haren e ëmbël të fisnikërisë të Saj, dhe unë parashtroj këtu nderimin mirë njohës e të thellë e ne të gjithve.

Mandej mendimi em kthehet me ndjenjat e mirënjoftjes mâ të gjallë ndaj gjith atyne, autoritete, përfaqësuesa e qytetarë, të cilët, tue pranue ftesën t'onë, janë mbledhun sot këtù reth nesh për me e bâ mâ

solemne këtë ceremonì inaugurimi t'onën, e veçanrisht ndaj Shkëlqesìve të Tyne Pjesëtarve të Qeverrìs' e Përfaqësuesve të Trupit Diplomatik që, tue na nderue me pranìn' e tyne, kanë dashtë me na dhanë një dëshmì të kënaqshme simpathije e mirëdashjeje.

Ceremonija e sotshme shënon për neve një datë kujtimore, tue qenë se inaugurimi i këtij pallati, me të cilin kemi dasht me i dhanë në Kryeqytet një selì të plotsueme e të stolisun Bankës Kombëtare të Emisjonit, formon për neve Administratorët dëshmì të vulosun për që j'a kemi mbrrijtun një qëllimi.

Me të vërtetë ishte konstatue prej kohësh nevoja për me i dhanë këtù një selì mâ të mirë Institutit t'onë; por neve kemi preferue me pritë deri sa ky të jepte prova të qên' jes së vetë e të konsolidohesh, kështu që pallati i rì të ish konsakrimi dhe simboli i një maturiteti dhe i një qëndrushmënije, tashmà e mbrrijtun plotsisht.

Ndërtesa e rè, vepër e ndritun e arkitektit të vlefshëm Prof. Morpurgo dhe e bashkpunëtorve të tij të zotë, në vijat e sajë të matuna e hijerândë aqsà edhe artistikisht elegante, dëshiron me qênë pikërisht shprehja dhe syntheza e atij organizmi të fort' e të sigurt siç âsht Banka Kombëtare e Shqipnìs.

E krijueme pak mâ tepër se dymbëdhetë vjet mâ parë me inisjativën e një grupi financjar Italian, gjithashtu me pjesëmarrjen modeste në të vërtetën, por jo mâ pak sinjifikative e të pëlqyeshme, të kapitaleve të hueja, e krijueme në një vênd ku lehtësinat dhe mjetet e kreditit mund të quheshin pothue të panjoftuna, ajo, Banka Kombëtare, kish përpara vedit dy qëllime esencjale për me mbrrijtë: Me i dhanë Shqipnìs një monedhë të mir' e të shëndoshtë dhe njëkohësisht me krijue një organ krediti që të ish një bazë dhe një shtytje drejt shvillimit ekonomik të sajë.

Mund të pohojmë me ndërgjegje të sigurtë se që të dy këtyne qëllimeve u kemi dalun në krye plotsisht.

Edhepsè nëpërmjet një stuhije që ende nuk ka marrun fund e që ka tronditun monedhat edhe ato mâ në zâ të shumë shteteve, Banka ka mundun me i sigurue qëndrimin mâ të fortë paritetit origjinal të arit të frangut shqiptar aq sa ky ka shënue shpesh, edhe në kohët e mbrame, një farë mbivleftje mbi metalin ar, ndërsà qarkullimi dhe detyrimet në të pâme kanë një mbulesë – për mâ se një të tretë në ar e për pjesën tjetër në aktivitete ekuivalente me tê – që âsht sjellë reth 85 e 90 për qind.

Njëkohësisht Instituti i ynë ka mundun me bâ të njoftun e me përhapë gjithnjë mâ tepër shërbimet e

kredìs, tue krijue në vênd tetë Dega, të cilat për së shpejti do të bâhen nandë, e tue zbritë herë mbas here kamatën e kushtimet e veprimeve, në mënyrë që me i bâ ballë sa mâ tepër që t'ish e mundun çdo eksigjence të shëndoshtë të lëvizjeve e të pagesave.

Këtë na shpjegon shtesa e konsiderueshme që âsht vërtetue në tânësinë e veprimeve të punës, veçanrisht n'atò të skontos që janë gàdi dyfishuem në pesvjetorin e fundit e që shkojnë ende tue u shvillue vazhdimisht.

Dëshira e jonë âsht me sjellë këtù kushtimin e të hollave në të njâjtin nivel t'Italisë fqinje e mbi këtë rrugë janë realizue hapa fort të mdhaja, kështu që jemi tue j'a mbrrijt qëllimit qëkursè, gjatë perjudhës së shkurtë t'ekzistencës s'onë, taksi zyrtar i skontos, që formon masën themelore, ka zbritë prej 12 në 6 për qind.

Me kryemjen e kësàj vepre Banka ka pasun kënaqësín' e madhe me pà kurdoherë të shtohet kundrejt sajë stima dhe besimi i publikut, nëpërmjet një klientele giithnjë të shumt' e besnike, depozitat e së cilës, kanë shkue përherë tue u rritë, veçanrisht në formën mâ sinjifikative të kursimit.

Të gjitha këtò janë pikë së pari rezultatet e kritereve e të direktivave që qysh prej fillimit j'u vunë si bazë Institutit e që, me rigorozitet të pa ndërprèm, u zbatuen kurdoherë.

Një ent bankar emisjoni, të cilit i bjen përgjegjësija e rândë për mbrojtjen e qëndrimit të monedhës kombëtare, ka për detyrë mâ kryesore mos me iu shmângë kurrë atyne principeve që janë themelorë për tê e që munden m'u përmbledhë: në mbajtjen e një ekuilibri të saktë midis qarkullimit, mbulesës, depozitave e derdhjeve të ndryshme, sidhe në të dhanunit e kredisë përgjithësisht vetëm me afat të shkurt' e vetëm kujt të jèt në gjëndje me paraqitë garancinat e nevojshme. Pa dyshim kjo sjellje rigoroze nuk mundet mos me shkaktue kritika instituteve të këtij lloji; e ashtu dhe neve kritikat e të pakënaqunve rrallë herë nuk na kanë mungue, porsè nuk kanë mundun kurrë të na shmângin nga rruga e jonë, e vetmja e drejtë dhe e shëndoshtë për interesin publik.

Tue përfillun me këtë rast me gëzim të madh ecjen e ndritun që kemi bâ deri tash ashtu edhe rezultatet e shkëlqyeshme të harrijtuna, âsht e detyrshme për mue e njëkohësisht e pëlqyeme me përkujtue veprën e të gjith'atyne që shum mâ mirë se un i dhanë Bankës kontribut pune të vleftëshme: veprën, para të gjithash, e predecesorve të mì të vlefshëm në Kryesì, atê të të ndershëmve bashkpunëtorë në Këshill, atê mâ në fund të të gjithë Personelit që meriton posaçërisht lëvdata për ndjenjën e naltë të detyrës, për zellin inteligjent e shpirtin e vetëmohimit me të cilin kudò e kurdoherë,

në Selitë Shqiptare dhe në Romë, përmbush detyrën e tij jo të lehtë. Ay ndjek kështù shembullin e Kryetarit të vetë mâ t'afërt, Administratorit te Deleguem Avv. Gambino, studjues i thellë i shkencavet ekonomike, i cili, qysh prej fillimit, i âsht konsakrue Bankës me një paraftyrim të ndritshëm të qëllimeve finale të kësajë, me kjartësì e qëndresë në kritere, me një drejtim e një kompetencë të krahasueshme vetëm me pasjonin e tij të madh për Institutin t'onë.

Por nuk janë vetëm këtà faktorët që na kanë dhanë mundsìnë me kapë pikëmbrrijtjen e dëshirueme.

Asht për këtë që due dhe jam i detyruem me përmêndë me mirënjoftje të madhe përkrahjen e fort' e të përzêmërt që na âsht dhanë kurdoherë nga Qeverrìja Kombëtare e Shqipnìs, edhe nëpërmjet një veprimi të çmueshëm legjislativ, përkrahje e cila ka qênë për neve një shkas nxitjeje e kuraje, aq mâ tepër se ajo dëshmon një bashkpunim që ka për themel të përbashkët atê të qëllimeve të drejtueme ndaj të mirës publike.

Kësajë i âsht përgjegjun mâ së miri populli shqiptar, i fortë e puntuer, i matun e kursimtar, skrupoloz në të kujdesunit për detyrimet e veta, i cili ka shkue tue

formue me Bankën përher' e mâ tepër marrdhanje të një mendimi, e të një besimi reciprok. Ay ka kuptue bukur se në sistemet serjozë e korrektë të ndjekun prej nèsh mundte me gjetë gjithnjë mbrojtjen mâ të mirë të interesave të veta; asaj klientele të afeksjonueme prà, që âsht formue për arësyet e këtilla, dëshirojmë me i drejtue këtù falnderimet t'ona, lëvdatën t'onë.

Tek e mbramja nuk mundem mos me përmêndë se, mëkâmbjes së situatës s'onë, i ka dhanë gjithashtù një kontribut të fortë vepra e Qeverrìs Fashiste t'Italìs, e cila, e frymëzueme nga miqsija e sajë tradisjonale kundrejt Shqipnìs, ka dhanë përherë e ende po jep, në forma të ndryshme, një tog mjetesh për shvillimin ekonomik dhe financjar të këtij Kombi.

Në Qeverrín' Italiane e në përfaqësuesat e ndritun të sajë këtù në Kryeqytet, veçanrisht në Ministrin e sotshëm Sh. T. Jacomoni, Banka e jonë ka gjetun kurdoherë – e jemi për këtë shumë mirnjoftës – përzêmërsì në marrdhânje, gjânsí këshillimi e përkrahjeje.

Dëshiroj gjith'aqë me shprehë ndjenjat e mirënjoftjes s'onë Shkëlqesìs së Tij Azzolini, Guvernator i vlefshëm i Banca d'Italia, që kam pasë rastin me e njoftë dhe me e çmue për vlerat e tij të nalta gjatë katër vjetve kur kisha nderin me kryesue si Ministër Financat Italiane. I përfaqsuem këtù prej Drejtorit të përgjithshëm

Dr. Troise, që edhe ky ish nji bashkpuntuer i em i vlefshëm, ai ka dasht me na dhanë një provë tjetër fort të pëlqyeshme të atij shpirti solidarsìje e mirëdashjeje që Instituti i madh Italian i ka tregue Bankës s'onë qysh nga origjina e që ka qênë për neve me të vërtet' i vlefshëm.

Por një Bankë emisjoni, mbas kalimit të një perjudhe fillestare, nuk mundet natyrisht, edhe në një vênd me ekonominë ende jo krejt të shvillueme, me përballë vetmas të tâna ekzigjencat, të tâna nevojat që mund të paraqiten në fushën e kreditit qoftë edhe tue ushtruem, siç lypet, kreditin ordinar. Vet natyra e sajë i imponon shtërngesa e përkufizime, ushtìma e të cilave shtrihet nganjëherë edhe deri në kredinat me afat të shkurtë, sepsè ajo, Banka e Emisjonit, nuk duhet kurrë me vû në radhë të dytë qëllimin kryesuer të sajë si mbrojtse dhe regulluese e monedhës.

Asht për këtê që, me kënaqsì të sinqertë, kemi pà në këtà vjetët e fundit m'u krijue krah për krah me né të tjera organizata kredinash, mâ parë Banque d'Exportation de Belgrade, mandej Banka Bujqsore e Shtetit e tash vonë një Degë e Banco di Napoli, Institut i vjetër e glorioz Italian.

Jemi të bindun se në këtë vënd të vuem n'udhë për përparime gjithnjë mâ të mdhaja, aktiviteti bankar mundet me iu dhanë të gjithve mundsì pune proporsjonale, veçanrisht sikur seicili institut (gjâ që pjesërisht âsht konstatue) të paravendosë me i dhânë aktivitetit të vetë një karakter specializimi siç ndodh përgjithsisht në marrdhânjet me Institutet e emisjonit. Prej një drejtimi të tillë ka me lindë pa dyshim një avantazh i sigurtë jo vetëm për Bankat por edhe për krejt ekonomin' e vendit.

Nën këtë drejtim neve, sikurse kemi veprue deri tash, do të vazhdojmë me iu ofrue Instituteve të përmênduna përkrahjen t'onë mâ të gjânë morale e materjale, të sigurtë se marrdhânjet e përzêmërta që kemi pasun përherë me tà, nuk do të munden veçsè të bâhen edhe mâ të ngushta për interesin publik.

Me këto ndjenja parashtroj një përshëndetje të përzêmërt të ndershëmve Përfaqsuesa të tyne që kanë pasun bujarinë me pranue ftesën t'onë tue marrë pjesë në mbledhjen e sotshme.

BKSH

Naltësi Mbretnore, Shkëlqesa, Zoja, Zotnìj,

Le të më jetë mâ së fundi e lejueshme – mbas kqyrjes së shpejtë që j'u dhà me kryenaltsì të ligjëshme rrugës së bâme ashtu edhe veprës së të shkuemes, gjithnjë në lidhje me të njâjtin kuptim që ka këjo ceremonì inaugurimi – le të më jet' e lejueshme të kthejmë me besim të kthjelltë mendimin t'onë nga e ardhmja.

Kombi fisnik Shqiptar, që vetëm prej një të katërt shekulli ka mundun, mbas shumë peripetìsh të hidhuna historike, m'u formue më vehte e i pamvarun dhe me vazhdue sistemin e vetë politik, gjatë kësaj perjudhe ka fillue, ngadalë por me sigurì, shvillimin ekonomik të tij.

Virtytet e forta e të shëndoshta të popullit të tij, pasunit' e tokës së tij, urtësija e qeverritarve të tij, ndën' udhëheqjen e një Sovrani meritplotë t'Atdheut të tij, japin besim të madh për të tjera përparime në lâmën e bujqsìs, t'industrìs e të tregtìs.

Banka Kombëtare quen për ndèr e për detyrë të saj' mâ të naltë, për detyrë esencjale, konsakrimin e vetë me besim e me pasjon për me favorizue këtë përparim

me çdo mjet që të disponojë; e prej rezultateve të deritashme nuk mundet veçsè me thurë urimet mâ të zgjedhuna për t'ardhmen e sajë, e ardhme këjò që âsht e lidhun ngushtë me atê të Kombit Shqiptar.

Na e dimë mirë se një Institut emisjoni, mâ parë se me sigurue fitime materjale aksjonistëve të vetë (aksjonistët t'anë, në të vërtetën, nuk marrin veçsè një shpërblim modest të kapitalit të tyne) duhet me vendosë që të kryejë një misjon të naltë, atê të mbrojtjes së interesave kombëtare në lâmën monetare dhe ekonomike.

Tue i ndêjtë me qëndresë e dashunì këtij koncepti, na interpretojmë plotsisht shpirtin e atyne që kanë kryesue në themelimin e kësaj Banke sidhe t'atyne që janë ende sot t'interesuem për tê.

Banka Kombëtare e Shqipnìs âsht, e duhet të jetë gjithmônë, jo vetëm një roj'e fortë dhe e qëndrueshme e Shtetit Shqiptar, e ekonomisë dhe e Pamvarësìs së Tij, por edhe shprehja mâ me rândsì e mâ e patundëshme e miqsìs vllaznore që lidh Shqipnìn me Italinë dhe e bashkpunimit të shtrêjtë e fekond midis dy popujve, që âsht për të gjithë garancì e sigurt paqje.

I frymëzuem nga këto ndjenja, Ju ftoj, Zotnìj, të brohoritni me mue për fatet e mbara të Shqipnìs.

BKSH

F. DAMASSO - ROMA - 1938

BKSK

BKSH

BKSH

BKSH